

Thirrja nga data 30.06.2025 deri në datën 08.07.2025

TERMAT E REFERENCES

PËR

EKSPERT/E PËR OFRIMIN E PUNËTORISË MBI TEMËN “FUQIZIMI I GRUPIT MONITORUES DHE HARTIMI I UDHËZUESIT PËR VLERËSIMIN E POLITIKËS PËR MBROJTJËN E FËMIJËVE NË EDUKIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOMUNËN E PRIZRENIT”

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI”
Objektiva	Hartimi dhe ofrimi i punëtorisë në temën “Fuqizimi i grupit monitorues dhe Hartimi i udhëzuesit për vlerësimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve në edukimin parauniversitar në komunën e Prizrenit” për anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF) në Prizren.

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

”Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve.

2. OBJEKTIVA

Qëllimi i kësaj punëtorie është të fuqizojë anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve të përfshirë në grupin monitorues komunal, duke i pajisur ata me njohuri të thelluara dhe aftësi praktike për të kuptuar rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në sistemin arsimor. Përmes një procesi interaktiv dhe gjithëpërfshirës, fëmijët do të njihen me përmbajtjen dhe qëllimet e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në arsimin parauniversitar, si dhe me mënyrat konkrete se si kjo politikë zbatohet në shkollat e komunës së Prizrenit.

Punëtorja do të synojë që pjesëmarrësit të jenë në gjendje të identifikojnë situatat kur të drejtat e fëmijëve mund të shkelën, të kuptojnë rëndësinë e një mjedisi të sigurt dhe përkrahës në shkollë, si dhe të kontribuojnë me mendimet dhe përvojat e tyre në procesin e hartimit të një udhëzuesi praktik për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kësaj politike.

Në fund të punëtorisë, pritet që anëtarët e Asamblesë të ndihen më të sigurt në rolin e tyre si vëzhgues aktivë dhe avokatë për të drejtat e fëmijëve, duke qenë një urë lidhëse ndërmjet bashkëmoshatarëve, shkollave dhe institucioneve komunale.

Nevo Koncepti kërkon një individë (ekspertë) për të ofruar dhe zhvilluar punëtorinë për grupin monitorues të përbërë nga Asamblesë Komunale të Fëmijëve, grup mosha e fëmijëve 12 – 15 vjeçar/e.

3. Kualifikimi i kandidatit/ës

Ekspteri/ja duhet të ketë aftësitë dhe njohurinë të nevojshme vijuese:

- Diplomë pasuniversitare (preferohet niveli Master) Drejtimi Shkenca Sociale, Psikologji, Edukim ose Shkenca Shoqerore.
- 5-7 vjet përvojë pune si Ekspert/e, duke përfshirë hartimin moduleve të punëtorisë dhe ofrimin e programeve
- Shkathtësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve
- Njohuri dhe shkathtësi për të komunikuar dhe punuar me fëmijë dhe të rinj
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore
- Të jetë fleksibil për tu përshtatur me orarin e përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), për të caktuar ditën e punëtorisë.
- Të jetë i/e aftë në komunikim me fëmijët, t'i mësoj dhe këshillojë fëmijët mbi temën.
- Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)

- Udhëheqë punëtorinë me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse në pajtim me 9 rregullat për pjesëmarrje të sigurt dhe kuptimplotë të fëmijëve: <https://resourcecentre.savethechildren.net/document/nine-basic-requirements-meaningful-and-ethical-childrens-participation/>

Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.

4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me 09 Korrik 2025. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të punëtorisë	Zhvillimi / adaptimi i programit të punëtorisë, përfshirë matrialet, si dhe të formojë vlerësimin Pre Post Test për 'Fuqizimi i grupit monitorues dhe Hartimi i udhëzuesit për vlerësimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve në edukimin parauniversitar në komunën e Prizrenit''	1	Korrik 2025
2	Ofrimi i punëtorisë për Grupin Monitorues të Asamblesë Komunale të Fëmijëve	Ofrimi i punëtorisë 1-ditor për grupin monitorues të Asamblesë së Fëmijëve Prizren	1	Korrik 2025
3	Përgaditja dhe përfundimi i udhëzuesit	Hartimi i udhëzuesit për vlerësimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve	5	Korrik 2025
4	Përfshirja e grupit monitorues	Prezantimi i udhëzuesit për vlerësimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve në edukimin parauniversitar.	1	
	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimit i raportit përfundimtar mbi angazhimin dhe Hartimi i Hartimi i udhëzuesit për vlerësimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve në edukimin parauniversitar në komunën e Prizrenit	1	Korrik 2025
	Gjithsej:		9	

5. REZULTATET E PRITSHME

- Rritja e kapaciteteve lokale për monitorim efektiv – Grupi monitorues (përfshirë anëtarët e Asamblesë së Fëmijëve) do të pajiset me një instrument praktik që i ndihmon të mbikëqyrin në mënyrë të strukturuar dhe sistematike zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkolla.
- Standardizimi i procesit të monitorimit në shkolla – Udhëzuesi do të ofrojë indikatorë të qartë, metoda vlerësimi dhe formate të unifikuara për mbledhjen e të dhënave, çka do të sigurojë një qasje të njëjtë në të gjitha shkollat.
- Përfshirja aktive e fëmijëve në vlerësim – Me udhëzuesin si mjet orientues, fëmijët (si pjesë e grupit monitorues) do të kenë mundësi të shprehin opinionet, përvojat dhe rekomandimet e tyre në mënyrë të strukturuar dhe me ndikim real.
- Identifikimi i boshllëqeve dhe sfidave në zbatim – Përmes përdorimit të udhëzuesit, shkollat dhe komuna do të jenë në gjendje të identifikojnë më lehtë problemet konkrete dhe zonat ku politika nuk po zbatohet plotësisht, duke ndihmuar në ndërmarrjen e hapave për përmirësim.
- Avokim më i bazuar në të dhëna – Rezultatet e monitorimit do të jenë të dokumentuara dhe të argumentuara, duke i mundësuar grupit monitorues dhe Asamblesë së Fëmijëve të avokojnë me prova konkrete për përmirësimin e politikave dhe praktikave në shkolla.
- Mbështetje për vendimmarrësit lokalë dhe shkollat – Udhëzuesi do të shërbejë si një burim orientues për Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe stafin e shkollave për të kuptuar më mirë si të sigurojnë zbatim të qëndrueshëm dhe efektiv të politikës.
- Përmirësimi i mjedisit shkollor për të gjithë fëmijët – Në afat të mesëm dhe afatgjatë, përdorimi i udhëzuesit do të kontribuojë në ndërtimin e një ambienti më të sigurt, mbrojtës, gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologjia e propozuar e mbajtjes së trajnimit.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 08.07.2025** në prokurimi@nevokoncepti.org